



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 20.10.2021

NJOFTIM PUNËSIMI

Bazuar në në Vendimin nr.1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, AZHBR shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si mëposhtë vijon :

I. SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE:

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b

Detyrat kryesore:

1. Plotëson dhe kujdeset për mirëmbajtjen e dosjeve të personelit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Asiston në organizimin e trajnimeve të ndryshme për stafin e ri.
3. Koncepton shkresa, urdhëra, njoftime dhe dokumenta të tjera në ndihmë të funksionimit të aktiviteteve të institucionit.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, në Shkenca Shoqërore, Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike. *(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).*
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
6. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Ligjin nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”,
- VKM 124 datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 26.10.2021, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjolleša”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONIN E MËSIPËRM, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL